



**PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR
ARSIMIN PARASHKOLLOR
*BASHKIA LIBRAZH***

Përmbajtja

1. Hyrje	3
1.1 Qëllimi	3
1.2 Shtrirja.....	4
1.3 Vizioni.....	4
1.4 Misioni	4
1.5 Objektivat.....	4
1.6 Përgjegjësit.....	4
2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	5
2.1 Qëllimi.....	5
2.2 Objektiva të përgjithshëm	5
2.3 Regjistrimi i fëmijëve	5
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht	5
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor	21
2.4.1 Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	21
3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit.....	56
3.1 Qëllimi.....	56
3.2 Objektiva të përgjithshëm	56
3.3 Përfshirja sociale.....	56
3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje	56
3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar.....	75
3.5.1 Adresimi i prindërve	75
4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	83
4.1 Qëllimi.....	83
4.2 Objektiva të përgjithshëm	83
4.3 Burimet Njerëzore.....	83
4.3.1 Rekrutimi i stafit	83
4.3.2 Trajnimi i stafit	89
4.4 Menaxhimi i godinave	96
4.4.1 Rikonstruksioni i kopshteve	96
4.5 Materialet	102
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale	102
5. Buxheti.....	107

1. Hyrje

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e Arsimit parashkollor. Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Librazhd. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

Bazuar në analizën e arsimit parashkollor në Bashkinë Librazhd, është evidentuar një ulje e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte krahasuar me vitin 2022-2023, duke krijuar shumë vende të lira. Problem kryesor është numri i lartë i grupeve të përziera në kopshte, ndërsa strukturat si Bordi dhe Këshilli i Prindërve nuk janë themeluar në të gjitha institucionet. Infrastruktura për fëmijët me aftësi të kufizuara është e pamjaftueshme dhe dokumentacioni për këta fëmijë mungon. Drejtimi i kopshteve në qytet bëhet nga dy drejtoresha, ndërsa në zonat rurale mësueset mbajnë përgjegjësinë. Fëmijët ndajnë të njëjtat ambiente me nxënësit e shkollave dhe bashkia dërgon materiale të ndryshme që shpërndahen dhe në kopshtet.

1.1 Qëllimi

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Librazhd dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Përmirësimi i shërbimit në kopshtet ku mungojnë regjistrimet në mënyrë që të rriten regjistrimet;
- Planifikim strategjik përpara i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përmirësimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;
- Ngritja e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të Arsimit Parashkollor, sipas së cilës sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet;
- Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka kopshti në zhvillimin e fëmijës;

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjik të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektivave të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe

indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm dhe më pas aktivitetet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e vendosur.

Ndërkohë në pjesën e tretë është përmbledhur buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

1.2 Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë e Librazhd. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Sektori i Arsimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Ligjore, Arsim Kulturës dhe Burimeve Njerëzore.

1.3 Vizioni

Përmirësimi i shërbimit të Arsimit Parashkollor, nëpërmjet ngritjes së strukturave për arsimin parashkollor dhe fuqizimin e tyre për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve.

1.4 Misioni

Shtimi i ambienteve arsimore për arsimin parashkollor dhe përmirësimi i cilësisë së tyre për të ofruar shërbim cilësor për çdo fëmijë të arsimit Parashkollor.

1.5 Objektivat

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i prindërve, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.

1.6 Përgjegjësit

1. Koordinator i planit:
 - Personi përgjegjës për Sektorin e Arsimit, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
2. Aktorët zbatues të planit:
 - Drejtuesit e kopshtit;
 - Mësueset e kopshtit;
 - Komuniteti;
 - Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF);
 - Psikologët;
 - Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN);
 - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
 - Kryetari i Bashkisë;
 - Këshilli i Bashkisë.

2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër për funksionimin e sistemit, duke përfshirë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë. Planifikimi i arsimit parashkollor bazohet në numrin e parashikuar të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, normën e regjistrimit dhe frekuentimit, duke marrë parasysh që arsimit parashkollor në Shqipëri nuk është i detyrueshëm. Kjo përfshin gjithashtu parashikimin e ofertës, si numrin e mësuesve dhe stafit mbështetës. Plani për përmirësimin e shërbimit synon të ulë mbipopullimin, të rrisë regjistrimet dhe të përmirësojë cilësinë e kopshtit..

2.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe rritja e regjistrimeve përmes ndërjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor;
2. Krijimi i konceptit të kopshtit si komunitet duke organizuar aktivitete në çdo kopsht ku komuniteti mund të marrë pjesë duke kontribuar në përmirësimin e shërbimit;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave si: Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e menaxhimit të kopshteve.

2.3 Regjistrimi i fëmijëve

2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht

Informacion i përgjithshëm

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Librazhd është 807, prej të cilëve 384 janë vajza. Bashkia Librazhd ka kapacitetet akomodues për **1264, ndërkohë ka të regjistruar për vitin shkollor 2023-2024 807 fëmijë në kopshtet publike. Gjithsej 680 fëmijë ndjekin kopshtin.**

Një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon ndjeshëm në numrin e regjistrimit është përmirësimi i infrastrukturës së kopshtit si dhe ofrimi i ushqimit në kopsht. Sipas bashkisë kopshtet me ushqim, në godinë më vete ose që janë rikonstruktuar së fundmi kanë numër më të lartë fëmijësh të regjistruar. E njëjta situatë vihet re edhe për kopshtet e reja të cilat kanë numër të lartë regjistrimesh.

Ndërkohë, ndarja e fëmijëve në grupe sipas grupmoshës mbetet akoma problematike për disa NjA. Sipas të dhënave vihet re që numri i fëmijëve të regjistruar në grupet e përziera është 485. Pozitiv është fakti që në këtë bashki ka një numër të lartë fëmijësh të regjistruar në grupin e tretë, konkretisht **123 fëmijë.**

Objektiva kryesore:

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetur në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit për të siguruar një shërbim efikas.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Unifikimi i të dhënave të arsimit parashkollor mes Bashkisë, ZVAP, NJA dhe kopshteve
2	Ulja e numrit të grupeve të përziara dhe fëmijëve në këto grupe
3	Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshte
4	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë Librazhd
5	Rregullimi i procedurës së regjistrimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të akteve formale

Indikatorët e performancës

Nën-objektivi: Ulja e numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në këto grupe

Treguesit	Të dhënat e indikatorit	Njësia e matjes	Formula e Llogaritjes:	Rezultati	Frekuenca e matjes	Dizagregimi
Indikatori i Reduktimit të Grupeve të Përziera (IRGP)	G_{t-1} : Numri i grupeve të përziera në vitin e kaluar G_t : Numri i grupeve të përziera në vitin e aktual	%	$IRGP = \frac{G_{t-1} - G_t}{G_{t-1}} \times 100$	Mat ndryshimin e numrit të grupeve të përziera në një periudhë të caktuar kohe (zakonisht vjetore) dhe përqindjen e uljes së këtij numri krahasuar me vitin e kaluar.	Vjetore	Qendër Periferi Fshat
Indikatori i Reduktimit të Fëmijëve në grupe të Përziera (IRFP)	F_{t-1} : Numri i fëmijëve në grupe të përziera vitin e kaluar. F_t : Numri i fëmijëve në grupe të përziera për vitin aktual.	%	$IRFP = \frac{F_{t-1} - F_t}{F_{t-1}} \times 100$	Mat reduktimin e numrit të fëmijëve të vendosur në grupe të përziera nga një periudhë kohore në tjetrën, si tregues i përmirësimit të organizimit në arsimin parashkollor	Vjetore	Qendër Periferi Fshat
Indikatori i Rritjes së përqindjes së Regjistrimit në Kopsht (IRRK)	R_{t-1} : Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte vitin a kaluar. R_t : Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte në vitin aktual.	%	$IRRK = \frac{R_{t-1} - R_t}{R_{t-1}} \times 100$	Mat përqindjen e rritjes së regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga një vit në tjetrin, duke treguar se sa është rritur numri i fëmijëve që marrin pjesë në arsimin parashkollor.	Vjetore	Qendër Periferi Fshat

Treguesit	Të dhënat e indikatorit	Njësia e matjes	Formula e Llogaritjes:	Rezultati	Frekuenca e matjes	Dizagregimi
Indikatori i Përqindjes së Fëmijëve të Identifikuar (IPFI)	N_{rezident} : Numri i total i fëmijëve resident të identifikuar në moshën e kopshtit N_{total} : Numri total i fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç që pritet të jenë në Bashkinë Librazhd (bazuar në të dhënat demografike ose regjistrin civil).	%	$IPFI = \frac{N_{rezident}}{N_{total}} \times 100$	Mat përqindjen e fëmijëve të moshës së kopshtit (3-5 vjeç) që janë resident të identifikuar dhe evidentuar nga strukturat lokale të Bashkisë Librazh në raport me numrin e përgjithshëm të fëmijëve që pritet të jenë në këtë grupmoshë.	Vjetore	Qendër Periferi Fshat
Indikatori i Efektivitetit të Procedurës së Regjistrimit (IEPR)	R_{rreg} : Numri i fëmijëve të regjistruar në përputhje me procedurat e reja. R_t : Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte në vitin aktual. fëmijëve të regjistruar	%	$IEPR = \frac{R_{rreg}}{R_t} \times 100$	Mat nivelin e zbatimit të procedurave të reja të regjistrimit dhe numrin e fëmijëve të regjistruar në përputhje me aktet formale të hartuara	Vjetore	Nuk aplikohet

Të dhënat e regjistrit të shërbimit;

Kodi i të dhënës	Emri i të dhënës	Përshkrimi i të dhënës	Disagregimi i të dhënës	Njësia matëse e të dhënës	Burimi i të dhënës	Personi Përgjegjës për prodhimin e të dhënës	Frekuenca e mbledhjes së të dhënës	Metoda e mbledhjes së të dhënës	Fakt 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027

TP001	G: Numri i grupeve të përziera në vitin aktual	Numri i grupeve të përziera që janë krijuar në kopshtet publike që menaxhohen nga bashkia, në fund të dhjetorit të vitit të raportimit.	Bashki	Numë r	Regjistri i kopshteve	Drejtoresha t e kopshteve	Vjetore	Të dhënat mblidhen përmes raportimeve të institucioneve arsimore dhe inspektimeve të kryera nga bashkia					
TP001/1			Qendër										
TP001/2			Periferi										
TP001/3			Fshat										
TP002	F: Numri i fëmijëve në grupe të përziera për vitin aktual.	Numri i fëmijëve në grupe të përziera që janë të regjistruar në kopshtet publike që menaxhohen nga bashkia, në fund të dhjetorit të vitit të raportimit.	Bashki	Nume r	Regjistri i kopshteve	Drejtoresha t e kopshteve	Vjetore	Të dhënat mblidhen përmes regjistrimeve nga regjistrat e kopshteve.					
TP002/1			Qendër										
TP002/2			Periferi										
TP002/3			Fshat										
TP003	R: Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte publike në	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike që menaxhohen nga bashkia,	Bashki	Numë r	Regjistri i kopshteve	Drejtoresha t e kopshteve	Vjetore	Të dhënat mblidhen përmes regjistrimeve nga regjistrat e kopshteve.					
TP003/1			Qendër										

TP003/ 2	vitin aktual	në fund të dhjetorit të vitit të raportimit, në të gjitha grupet mësimore të arsimit parashkollor	Periferi										
TP003/ 3			Fshat										
TP004	N_{rezident}: Numri i total i fëmijëve resident të identifikuar në moshën e kopshtit	Numri i fëmijëve të identifikuar resident në territor, në moshën e kopshtit 3-6 vjeç	Bashki	Numë r	Të dhëna nga censusi Të dhëna nga regjistrat e vaksinimit Të dhënat nga administratorët	Personi përgjegjës në strukturën e administrimit të shërbimit në bashki	Vjetore	Të dhënat mblidhen nga regjistrat e vaksinimit, ose të dhënat e censurit, ose nga administratorët e njesive					
TP004/ 1			Qendër										
TP004/ 2			Periferi										
TP004/ 3			Fshat										
TP005	N_{total}: Numri total i fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç që pritet të jenë në Bashkinë Librazhd	Numri total i fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç që pritet të jenë në Bashkinë Librazhd	Bashki	Numë r	Të dhënat demografike ose regjistrin civil/censurit).	Personi përgjegjës në strukturën e administrimit të shërbimit në bashki	Vjetore	Të dhënat mblidhen përmes regjistrave demografikë të mbajtur nga gjendja civile në Bashki					
TP005/ 1			Qendër										
TP005/ 2			Periferi										
TP005/ 3			Fshat										

TP006	Rrreg: Numri i fëmijëve të regjistruar në përputhje me procedurat e reja.	Numri i fëmijëve të regjistruar në përputhje me procedurat e reja të miratuara, duke përdorur formularë standard dhe përditësime të rregullta nga stafi administrativ e.	Nuk aplikohet	Numë r	Sistemi i menaxhimit të regjistrimit të fëmijeve në kopshte	Drejtoresha t e kopshteve	Vjetor	Të dhënat mblidhen përmes sistemit të menaxhimit të regjistrimit të kopshteve;					
-------	--	--	---------------	--------	---	---------------------------	--------	--	--	--	--	--	--

Lista e Aksioneve

Nr.	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Total periodhe
004	Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve	Sektori i Arsimit					
003	Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Sektori i Arsimit					
002	Planifikim dhe parashikimi i numrit të fëmijëve 3-6 vjeç që do të frekuentojnë kopshtin.	Sektori i Arsimit					
001	Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit	Sektori i Arsimit					

Lista e projekteve

Nr. 001	Projekti: Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Regjistrimi i fëmijëve në kopshte bëhet sipas vendbanimit, por në raste të veçanta pranohet edhe regjistrimi jashtë zonës, sidomos kur kopshti ka vende bosh. Kjo ndodh për arsye si punësimi i prindërve afër kopshtit. Prioritet u jepet fëmijëve në nevojë, ku bashkia bashkëpunon me shërbimet sociale për të lejuar regjistrimin pranë vendit të punës së prindërve ose pranë shtëpive të gjyshërve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Shpërndarja jo e barabartë e fëmijëve në kopshte shkakton mbipopullim të disa kopshteve dhe nënpopullim të kopshteve të tjera. Mbiipopullimi i kopshteve shkakton pengesa në procesin e edukimit dhe menaxhimit të fëmijëve, ndërsa nënpopullimi bën që hapësirat, në të cilat është investuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, të mos shfrytëzohen maksimalisht.		
ii Synimi i projektit Për të siguruar shpërndarjen e barabartë të fëmijëve në kopshte është e rëndësishme të sigurohet që cilësia e shërbimit të të gjithë kopshtet është e njëjtë dhe regjistrimi kryhet sipas zonës së banimit dhe jo preferencave të prindërve. Ky projekt përqëndrohet në realizimin e regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit nëpërmjet përcaktimit të një rregulloreje, e cila do të ndiqet nga të gjitha kopshtet.		
iii Niveli i ndërhyrjes		

1. Urdhër nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet pranë zonës së tyre të banimit;
2. Hartimi i një rregulloreje që përcakton procedurën, aktorët përgjegjës, afatet kohore dhe mënyrën e ndërveprimit ndërmjet palëve gjatë procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga Drejtoria e Arsimit. Vendbanimi është i shkruar në certifikatë.

Një model i rregullores mund të jetë si më poshtë:

1. Prindërit, përveç dokumenteve të tjera, duhet të dorëzojnë edhe Certifikatën e Vendbanimit. Afati për dorëzimin e dokumenteve është nga 1 deri më 10 qershor.
2. Kopshti dorëzon dokumentet e marra nga prindërit në Drejtorinë e Arsimit brenda 2 ditëve pas përfundimit të afatit të regjistrimit.
3. Drejtoria e Arsimit shqyrton dokumentet dhe, bazuar në listën e fëmijëve në moshë kopshti, vendos mbi pranimin ose refuzimin e aplikimeve. Afati për marrjen e vendimeve është deri në fund të qershorit. Identifikohen gjithashtu fëmijët që ende nuk janë regjistruar.
4. Në rast refuzimi, prindërit njoftohen nga drejtuesi i kopshtit dhe sugjerohet një kopsht tjetër i përshtatshëm për fëmijën.
5. Hartimi i një kontrate mes prindërve dhe kopshtit për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.
6. Pas përfundimit të regjistrimeve, drejtorët apo mësuesit e kopshtit mund të takojnë prindërit që nuk kanë regjistruar fëmijët e tyre për të kuptuar arsyet dhe për t'i informuar mbi rëndësinë e arsimit parashkollor. Kjo detyrë mund t'i delegohet edhe punonjësve të terrenit për të identifikuar fëmijët në situatë rruge.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin sipas zonës së banimit; *(Çdo vit në muajin maj)*
2. Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit;
3. Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit;
4. Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve;
5. Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht;
6. Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit;
2. Shpërndarje e njëjtë e regjistrimit të fëmijëve;
3. Rritje e numrit të regjistrimeve;
4. Ulje e numrit të grupeve të përziera dhe/ose numrit të fëmijëve në këto grupe.
5. Me urdhër të Kryetarit të pranohen vetëm raste të veçanta të regjistrimit të fëmijëve sipas një procedure të caktuar, në kopshte të cilat ndodhen jashtë zonës së vendbanimit.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit
- Kryetari i Bashkisë

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Prindërit/Persona me përgjegjësi prindërore
- Drejtues/mësues të kopshteve
- Grupet e Terrenit

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emërtimi	Përgjegjës	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Total
1	Nxjerrja e Urdhrit për regjistrimin sipas zonës së banimit	Kryetari i Bashkisë					
2	Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit	Drejtorja e Arsimit					
3	Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit	Drejtorja e Arsimit					
4	Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve	Drejtorja e Arsimit					
5	Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht	Drejtorja e Arsimit					
6	Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve	Drejtorja e Arsimit/drejtues/mësues/Grupet e Terrenit					
f) Periudha e zbatimit:		g) Ndjek zbatimin e projektit:					
		Drejtorja e Arsimit					

Nr. 002	Projekti: Planifikim dhe parashikimi i numrit të fëmijëve 3-6 vjeç që do të frekuentojnë kopshtin.	Programi Buxhetor: - 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>i Situata Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Nenin 23, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e tyre për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe. Në Bashkinë Librazhd nuk ka një planifikim të qartë për identifikimin e numrit të parashikuar të fëmijëve 3-6 vjeç që do të frekuentojnë kopshtet.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Në Bashkinë Librazhd, nuk merren të dhëna nga institucionet e tjera për fëmijët në moshë kopshti 3-6 vjeç dhe si pasojë nuk bëhet një planifikim të mirëfilltë për identifikimin e numrit të parashikuar të fëmijëve 3-6 vjeç të cilët do të frekuentojnë kopshtin.</p>		
<p>ii Synimi i projektit</p> <p>Krijimi i një sistemi të unifikuar i të dhënave në kohë reale për të përmirësuar planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve më efikase nga institucionet përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Marrja e informacionit nga Zyrat e Gjendjes Civile pranë bashkisë ose Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për numrin e fëmijëve në moshën e regjistrimit në kopshte sipas njësive administrative, grupmoshës dhe gjinisë (shkresë). ○ Konsultohuni me Administratorët e njësive administrative për të përfshirë të dhënat mbi numrin e fëmijëve sipas njësive administrative, grup moshës dhe gjinisë. Administratorët e njësive mund ta mbledhin këtë të dhënë në territor (urdhër i Kryetarit/Zv. kryetarit). ○ Merni të dhënat nga drejtuesit e kopshteve ose mësuesit përgjegjës për numrin aktual të fëmijëve të regjistruar në kopsht sipas njësive administrative dhe gjinisë. ○ Mbledhja e të dhënave nga listat e fëmijëve të vaksinuar të moshës 3-6 vjeç nga Qendrat Shëndetësore. ○ Koordinimi me Drejtorinë e Shërbimit Social për të identifikuar fëmijët që ndodhen në situatë rruge të moshës 3-6 vjeç. ○ Marrja e informacionit nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Programi për Aftësi të Kufizuara (PAK) për identifikimin e fëmijëve me aftësi ndryshe. ○ Marrja e informacionit nga sistemi i të dhënave nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve. 		
<p>iii Niveli i ndërhyrjes</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Analizimi i të dhënave të viteve të kaluara dhe tendencat e regjistrimit për të parashikuar numrin e fëmijëve që do të regjistrohen. 2. Krijimi i udhëzimeve të posaçme që do të ndihmonte në projektimin e pritshmërisë së bashkisë për regjistrimin e fëmijëve vit mbas viti. 3. Krijimi i një regjistri elektronik që do të ruante regjistrimet e fëmijëve gjatë tre viteve të fundit. Gjenerimi i analizave dhe planifikimi i ndërhyrjeve nga Sektori i Arsimit. 		
iv Aktivitetet kryesore të projektit		

<ol style="list-style-type: none"> 1. Krijimi i një regjistri me të dhënat analitike të kopshteve dhe gjenerimi i analizave. 2. Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave. Stafi i kopshteve, Sektori i Arsimit, Drejtorisë së Planifikimit e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Social njihet me rregulloren. 							
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) <ol style="list-style-type: none"> 1. Platforma Digjitale me të dhënat individuale të kopshteve të plotësuara në kohë reale 2. Analiza e Situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve 3. Koordinimi më i Mirë Ndërinstitucional 							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Arsimit • Drejtoria e Planifikimit e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit • Sektori i Prokurimeve 				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> • ZVAP; • Njësitë Administrative. 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti i Viti 2027	Total
1	Krijimi i një regjistri me të dhëna analitike për kopshtet.	Sektori i Arsimit/Sektori i Prokurimeve Drejtoria e financave					
2	Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza	Operatori ekonomik/Sektori i Arsimit					
3	Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave	Sektori i Arsimit					
f) Periudha e zbatimit:				g) Ndjek zbatimin e projektit: Sektori i Arsimit			

Nr. 003	Projekti: Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje ose aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor jo e kënaqshme. Në NjA numri i fëmijëve të regjistruar është i ulët. (Kjo mund të vijë si pasojë e numrit të paktë të lindjeve. Thuaje 95% e fëmijëve shkojnë në kopsht.)		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Mospërfshirja e komunitetit në çështjet e arsimit parashkollor tregon mungesë interesi, që mund të jetë një arsye për numrin e ulët të regjistrimeve në kopshte në Njësitë Administrative. Kjo situatë krijon grupe të përziera, të cilat janë më të shumta se grupet e rregullta dhe me numër të lartë fëmijësh, duke vështirësuar menaxhimin. Për më tepër, me fokusin e Bashkisë në programe të tjera strategjike, buxheti për arsimin parashkollor mund të mos jetë i mjaftueshëm për zgjidhjen e problemeve, si rikonstruksioni dhe ndërtimi i kopshteve.		
ii Synimi i projektit Përfshirja e komunitetit në aktivitete synon të rriti ndërgjegjësimi e komunitetit (përfshirë prindërit) për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve dhe si pasojë pritet të rritet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve që kanë nevojë të theksohen përsa i përket arsimit parashkollor. Nëpërmjet aktiviteteve të iniciuara nga Njësia e Arsimit Parashkollor dhe vënia në zbatim nga drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve, synohet: <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i fëmijëve: Aktivitetet do të kenë në qendër fëmijët që do të recitojnë, tregojnë përralla dhe kërcyejnë, duke rritur aftësitë e tyre për të bashkëpunuar dhe mësuar. 2. Informimi i komunitetit: Sesione të shkurtra informuese do të ndihmojnë komunitetin të kuptojë rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për angazhim. Komuniteti do të mund të llojë për rritjen e buxhetit për kopshtet. 3. Rritja e regjistrimeve: Aktivitetet do t'u japin prindërve mundësinë të njihen me kopshtet, mësueset dhe përfitimet e arsimit parashkollor, duke rritur kështu normën e regjistrimit. 4. Ulja e grupeve të përziera: Me rritjen e regjistrimeve, do të zvogëlohet numri i fëmijëve në grupet e përziera, duke përmirësuar organizimin e tyre. 		
iii Niveli i ndërhyrjes <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopshtet në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve planifikon aktivitetet. 2. Kalendari i aktiviteteve i dërgohet Njesisë së Arsimit Parashkollor; 3. Organizohen takime me komunitetin për krijimin e Grupit të Vullnetarëve. 		
iv Aktivitetet kryesore të projektit Për vitin shkollor, kopshti dhe prindërit bashkëpunojnë për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve që plotësojnë nevojat e fëmijëve dhe komunitetit. Prindërit informohen rregullisht dhe inkurajohen të marrin pjesë në veprimtaritë e kopshtit. Në bashkëpunim me bashkinë, krijohen grupe vullnetarësh për të ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Gjatë		

vitet, kopshti ofron aktivitete në ambiente të hapura, duke përfshirë prindërit dhe komunitetin në mbështetje të fëmijëve dhe veprimtarive të tyre.							
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht; 2. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht; 3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre. 							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Arsimit 				<ul style="list-style-type: none"> • Komuniteti • Kopshti • Gjinnazet 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Total
1	Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve	Drejtues i kopshtit					
2	Shqyrtimi me Bordin e Kopshtit	Drejtues i kopshtit					
3	Takim me Këshillin e Prindërve	Drejtues i kopshtit					
4	Organizimi i aktiviteteve	Drejtues i kopshtit					
f) Periudha e zbatimit:				g) Ndjek zbatimin e projektit:			
				Sektori i Arsimit			

Nr. 004	Projekti: Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Aktualisht, nuk ka një metodë të unifikuar për vlerësimin e brendshëm të kopshteve, i cili synon analizimin e pikave të forta dhe mundësive për përmirësim. Vetëvlerësimi bëhet më efektiv kur rezultatet përkthehen në plane zhvillimi që identifikojnë objektivat dhe burimet për ndryshim.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i brendshëm: <ol style="list-style-type: none"> 1. përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin; 2. kryhet çdo vit; 3. mbulon të gjitha fushat që përfshin monitorimi dhe vlerësimi i IA-së; 4. vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel individual (drejtori, mësuesi, psikologu) dhe në nivel organizmesh. 		
ii Synimi i projektit Vlerësimi i brendshëm i kopshteve ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime. Ky projekt ka si synim hartimin e një metode të unifikuar për të gjithë kopshtet për të kryer çdo vit vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohen fushat mbi të cilat realizohet vlerësimi i brendshëm. Përvoja ka treguar që duhet që vlerësimi i brendshëm të ketë të njëjtat fusha mbi të cilat realizohet vlerësimi i jashtëm i kopshtit.		
iii Niveli i ndërhyrjes <ol style="list-style-type: none"> 1. Nxjerrja e një udhëzuesi metodologjik për vlerësimin e brendshëm të kopshtit. ASCAP ka hartuar tashmë udhëzuesin metodologjik për vlerësimin e brendshëm të shkollës. 2. Nxjerrja e Urdhrit nga Kryetari i Bashkisë. 3. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për vlerësimin e brendshëm bazuar mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm të Shkollës/Kopshtit nga ASCAP; 4. Drejtuesi i kopshtit organizon një fokus grup me personat me përgjegjësi prindërore, mësuesit dhe anëtarë të tjerë të organizmave të kopshtit për të diskutuar për një numër të vogël temash ose aspektesh që lidhen me kopshtin. Fokus grupi zhvillohet në periudhën kohore të pranuar nga të gjithë anëtarët dhe ka 6-8 pjesëmarrës; 5. Koordinator i grupit, me ndihmën e koordinаторit të ZVAP, harton analizën përmbledhëse të vlerësimit të brendshëm. 6. Rezultatet mund të përdoren për hartimin e planit afatmesëm të kopshteve ose planeve vjetore. 		
iv Aktivitetet kryesore të projektit <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve nga ASCAP; 2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga ASCAP; 3. Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshteve; 4. Organizimi i fokus grupeve; 5. Analiza dhe raportimi i rezultateve. 		

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryerja çdo vit e vlerësimit të brendshëm të kopshtesipas udhëzimit të posaçëm të MAS; 2. Nxitja për vet-përmirësim i mësuesve, drejtuesve dhe organizmave të kopshteve; 3. Planifikimi më objektiv bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm. 							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Arsimit. 				<ul style="list-style-type: none"> • ZVAP; • ASCAP. 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Total
1	Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve	ASCAP					
2	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	ASCAP					
3	Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	Drejtuesit e kopshteve					
4	Organizimi i fokus grupeve	Drejtuesit e kopshteve					
5	Analiza dhe raportimi i rezultateve	Koordinator i Grupit dhe ZVAP					
6	Rinovim i rregullores së kopshteve	Sektori i Arsimit					
f) Periudha e zbatimit:				g) Ndjek zbatimin e projektit:			
				Sektori i Arsimit			

Risqet

Risku	Mitigimi
Regjistrimi fëmijëve sipas zonës së banimit mund të detyrojë prindërit të regjistrojnë fëmijët në kopshte që nuk janë pranë zonës ku ata banojnë realisht, por në kopshte ku kanë zonën e banimit zyrtarisht.	Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë që fëmija e tyre të regjistrohet pranë zonës së tyre reale të banimit, nëse mund ta vërtetojnë në mënyrë zyrtare nëpërmjet një kontrate qiraje, kontrate pune, hipoteka e shtëpisë, etj.

2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

2.4.1 Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

Nga analiza e arsimit parashkollor në Bashkinë Librazhd, rezulton se kopshtet që ndodhen brenda ambienteve të shkollave funksionojnë me organizmat e të shkollës dhe nuk kanë themeluar organizma të veçantë të dedikuar për kopshtin.

Në bazë të Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë” vendosen të ngrihen të gjithë organizmat e kopshtit.

Ngritja e Organizmave të kopshtit

1. Përgjegjësinë për ngritjen e organizmave të kopshtit e ka përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore drejton mbledhjet e këshillit të mësuesve për zgjidhjen e mësuesit në bord dhe organizon përfshirjen në bord të pjesëtareve të tjerë nga komuniteti.

Funksionimi i Organizmave të kopshtit

1. Bordi i kopshtit zgjidhet një herë në tre vjet dhe përsëritja e mandatit nuk është e kushtëzuar.
2. Mandati i përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore bëhet një herë në katër vjet me të drejtë rrizgjedhjeje.
3. Kryetari ose anëtarët e bordit largohen nga Bordi kur gjatë dy viteve të njëpasnjëshme mungon në të paktën gjysmën e mbledhjeve të tij. Bordi nëpërmjet sekretarit të tij, njofton me shkrim institucionin/organin përkatës për largimin e përfaqësuesit të tij nga bordi. Zëvendësimi i përfaqësuesit kryhet nga të njëjtat organe/institucione brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, sipas procedurave të përshkruara në Udhëzimin Nr.25 datë 25.7.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor.”

Objektiva kryesore:

Themelimi i Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 25 dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në të gjithë Kopshtet.
2	Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në menaxhimin e kopshtit

Indikatorët e performancës

Nën-objektivi: Fuqizimi i Këshillit të Prindërve

Treguesi	Të dhënat e indikatorit	Njësia e matjes	Formula e Llogaritjes:	Rezultati	Frekeunca e matjes	Dizagregimi
Indikatori e Zgjidhjes së Problemeve të Ngritura nga Këshilli i Prindërve (IZP_KP)	P_{zgjidhuraKP} : Numri i problemeve të zgjidhura nga Këshillat e Prindërve P_{ngrituraKP} : Numri i problemeve të ngritura nga Këshillat e Prindërve	%	$IZP_{KP} = \frac{P_{zgjidhuraKP}}{P_{ngrituraKP}} \times 100$	Mat përqindjen e problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve që janë zgjidhur brenda një viti.	Vjetore	Qendër Periferi Fshat
Indikatori për Frekuencën e Mbledhjeve të Këshillit të Prindërve (IFM_KP)	N_{mbledhjeKP} : Numri i mbledhjeve të mbajtura nga Këshillat e Prindërve Periudha : Periudha kohore e caktuar (vit)	Numër	$IFM_{KP} = \frac{N_{mbledhjeKP}}{PeriudhaKP}$	Mat numrin e mbledhjeve të organizuara nga Këshillat e Prindërve gjatë një periudhe një vjecare	Vjetore	Qendër Periferi Fshat
Indikatori për Pjesëmarrjen e Këshillit të Prindërve në Aktivitetet e kopshtit (IPA_KP)	N_{pjesemarrjeKP} : Numri i aktiviteteve ku kanë marrë pjesë Këshillat e Prindërve N_{aktiviteteKopshte} : Numri total i	%	$IPA_{KP} = \frac{N_{pjesemarrjeKP}}{N_{aktiviteteKopshte}} \times 100$	Mat nivelin e angazhimit të Këshillave të Prindërve në aktivitetet e organizuara nga kopshtet.	Vjetore	Qendër Periferi Fshat

Treguesi	Të dhënat e indikatorit	Njësia e matjes	Formula e Llogaritjes:	Rezultati	Frekuenca e matjes	Dizagregimi
	aktiviteteve të organizuara nga kopshtet.					
Indikatori i Pjesëmarrjes së Prindërve në Këshillin e Prindërve (IP _{KP})	N _{tPrinderKP} : Numri mesatar i prindërve të anëtarësuar në Këshillat e Prindërve në vitin aktual N _{t-1PrinderKP} : Numri mesatar i prindërve të anëtarësuar vitin e kaluar	%	$IP_{KP} = \frac{(N_{tPrinderKP} - N_{t-1PrinderKP})}{N_{t-1PrinderKP}} \times 100$	Mat përqindjen e rritjes së numrit të prindërve që marrin pjesë në Këshillin e Prindërve gjatë periudhave një vjeçare, duke treguar angazhimin dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje.	Vjetore	Qendër Periferi Fshat
Indikatori i Rritjes së Trajnimeve për Këshillin e Prindërve (IRRT _{KP})	N _{tTrajnimeKP} : Numri i trajnimeve të këshillave të prindërve të organizuara në periudhën aktuale. N _{t-1TrajnimeKP} : Numri i trajnimeve të organizuara në periudhën e kaluar (referuese).	Numër	$IRRT_{KP} = N_{tTrajnimeKP} - N_{t-1TrajnimeKP}$	Mat ndryshimin në numrin total të trajnimeve të organizuara për Këshillin e Prindërve gjatë një periudhe 1-vjeçare, krahasuar me periudhën paraprake, duke reflektuar përpjekjet për fuqizimin e anëtarëve në menaxhimin e çështjeve arsimore	Vjetore	Nuk aplikohet

Treguesi	Të dhënat e indikatorit	Njësia e matjes	Formula e Llogaritjes:	Rezultati	Frekuenca e matjes	Dizagregimi
				dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre.		
Indikatori Përqindja e Kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve (IPK _{KP})	N _{kopshteKP} : Numri i kopshteve me keshill të prindërve të themeluar.	%	$IPK_{KP} = \frac{N_{kopshteKP}}{N_{totalKopshte}} \times 100$	Mat përqindjen e kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve, duke u bazuar në të dhënat për numrin e kopshteve që kanë përfunduar këtë process.		Qendër Periferi Fshat

Të dhënat e regjistrit të shërbimit:

Kodi i të dhënës	Emri i të dhënës	Përshkrimi i të dhënës	Disagregimi i të dhënës	Njësia matëse e të dhënës	Burimi i të dhënës	Personi Përgjegjës për prodhimin e të dhënës	Frekuenca e mbledhjes së të dhënës	Metoda e mbledhjes së të dhënës	Fakt 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
TP007	P _{ngrituraKP} : Numri i problemeve të ngritura nga Këshillat e Prindërve	Numri i problemeve të ngritura nga këshillat e prindërve në kopshtet publike që menaxhohen nga bashkia, në	Total Bashki	Numër	Procesverbale të mbledhjeve të këshillave të prindërve	Drejtoreshat e kopshteve, personi përgjegjës në bashki/inspektori i kopshteve.	Vjetore	Të dhënat mbliidhen përmes raportimeve të institucioneve arsimore dhe					
TP007 /1			Qendër										
TP007 /2			Periferi										

TP007 /3		fund të dhjetorit të vitit të raportimit.	Fshat					inspektim eve të kryera nga bashkia					
TP008	P zgjidhura KP : Numri i problemeve të zgjidhura nga Këshillat e Prindërve	Numri i problemeve të zgjidhura nga këshillat e prindërve në kopshtet publike që menaxhohen nga bashkia, në fund të dhjetorit të vitit të raportimit.	Bashki	Numer	Procesverb alet e mbledhjeve të këshillave të prindërve	Drejtoreshat e kopshteve, personi përgjegjës në bashki/inspektori i kopshteve	Vjetore	Të dhënat mblidhen përmes raportimeve të institucioneve arsimore dhe inspektimeve të kryera nga bashkia					
TP008 /1			Qendër										
TP008 /2			Periferi										
TP008 /3			Fshat										
TP009	N mbledhje KP :Numri i mbledhjeve të mbajtura nga Këshillat e Prindërve	Numri i mbledhjeve të mbajtura nga këshillat e prindërve në kopshtet publike që menaxhohen nga bashkia, në fund të dhjetorit të vitit të raportimit.	Bashki	Numër	Procesverb alet e mbledhjeve të këshillave të prindërve	Drejtoreshat e kopshteve, personi përgjegjës në bashki/inspektori i kopshteve	Vjetore	Të dhënat mblidhen duke numëruar nr e mbledhjeve përmes raportimeve të institucioneve arsimore dhe inspektimeve të kryera nga bashkia					

TP010	NpjesemarrjeKP: Numri i aktiviteve ku kanë marrë pjesë Këshillat e Prindërve	Tregon numrin e aktiviteve ku kanë marrë pjesë këshillat e prindërve në kopshtet publike që menaxhohen nga bashkia, në fund të dhjetorit të vitit të raportimit.	Total Bashki	Numër	Raportim për aktivitetet e kopshteve	Drejtoreshat e kopshteve, personi përgjegjës në bashki/inspektori i kopshteve	Vjetore	Të dhënat mblidhen duke numëruar nr. e aktiviteve e ku kanë marrë pjesë këshillat e prindërve, përmes raportimeve të institucioneve arsimore dhe inspektimeve të kryera nga bashkia					
TP010 /1			Qendër										
TP010 /2			Periferi										
TP010 /3			Fshat										
